

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 10 SHKURT 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Për fat të keq, nuk doja ta vazhdoja replikën që fillova nga vendi, por vërtet kam dëgjuar shpjegime qesharake. Ju nuk duhet të jeni absolutisht e keqardhur që gjatë diskutimit për ndryshimin e Kushtetutës kjo është salla që drejtoni ju! Ja, kjo është salla! Ky duhet të ishte diskutimi më i vështirë, më gjithëpërfshirës, por është katandisur në këtë gjendje. Nëse ju do të ndiheni mirë, aferim, ne nuk ndihemi mirë dhe duam të respektohet Rregullorja, e cila nuk ka asnjë lidhje me pandeminë; meqenëse doni ta diskutojmë edhe në rrafshin profesional, nëse votat do të numërohen në orën 16:00, në orën 17:00 apo në 18:00, kjo vetëm me pandeminë nuk ka lidhje, megjithëse është një spekulim, që le të rrijë atje ku është, në trupin e tij. Tani të kthehemi te rendi i ditës. Unë besoj se është një moment shumë i vështirë sot, sepse detyrohemi të diskutojmë sërish për Kushtetutën, për reformën në drejtësi, së cilës i kishim dhënë një përgjigje më 21-22 korrik të vitit 2016. Sot do të ishim duke lexuar rezultatet dhe realizimet shumë pozitive të kësaj reforme, për të cilën u shpenzua kohë, nerva dhe propagandë. Çfarë qëllimesh kishte reforma në drejtësi? Qëllim kryesor kishte paanshmërinë, pra të ishte e pakapur nga kurrkush. Por unë besoj se është drejtësia më e kapur që ka ekzistuar në historinë e Shqipërisë. Këtë do të kemi mundësi ta shtjellojmë me fakte konkrete. A do të ishte më e shpejta? Absolutisht, jo. Proceset janë shtyrë me vite dhe falë hartës gjyqësore edhe shërbimi gjyqësor është larguar nga qytetarët. A është më profesionale? Jo dhe jo. Sepse mbingarkesa e jashtëzakonshme e gjyqtarëve, mungesat e mëdha në sistem kanë bërë që sot qytetarët, në vend të lexonin ndryshime të mëdha pozitive, për të cilat bëhet një reformë (pasi reformë do të thotë përmirësim i situatës), sot të gjithë me plot gojën, për fat të keq, thonë se ishin më mirë kur ishin më keq. Cilat janë faktet reale?

Faktet janë shumë të dhimbshme dhe unë provoj një dhimbje të dyfishtë, pasi duke qenë anëtar i komisionit të reformës në vitin 2016, dhe vota ime në atë kohë ishte përcaktuese që ajo reformë të vinte në sallë, e votova me bindjen që do të kishim një sistem drejtësie thellësisht më të mirë dhe me integritet. Opozita nuk merrte pjesë dhe kishte bojkotuar procesin, një bojkotim që hapi një autostradë të kapjes së reformës në drejtësi. Të ndalemi me radhë tek ai që është argumenti i ditës, vetingu. Çfarë ndodhi me vetingun? Vetingu kishte tri shtylla. Të gjithë ata që ishin anëtarë të komisionit të reformës, ka nga ata anëtarë të komisionit që janë edhe në sallë, po të duan le të replikojnë dhe të thonë se nuk është e vërteta kështu, pra, vetingu kishte tri këmbë: verifikimin e pasurisë, integritetin moral dhe integritetin profesional. Integriteti moral dhe profesional ishin thelbësorë, pasi për kontrollin e pasurisë, sido që të vijë puna, kemi një institucion, i cili ngrihet nga parlamenti, që është ILDKPKI-ja, pra ka mjaft prurje, mjaft të dhëna dhe është një proces shumë herë më i kontrolluar. Po si degradoi vetingu? Vetingu degradoi në ILDKPKI-2, pra një shtesë e inspektoratit të pasurive. Ajo për të cilën qytetarët janë shqetësuar nga drejtësia e vjetër, e ashtuquajtur e tillë, janë vendimet e padrejta dhe integriteti i tyre, por numri i të larguarve për këto shkaqe është qesharak dhe minimal.

Pra, qëllimi parimor për të cilin ky instrument u ngrit, duke u kërkuar me zë të lartë dhe duke u bërë gjithë ajo propagandë, degradoi në këtë nivel, pra të një ILDKPKI -je shtesë. Veç të tjerave, pati edhe problemin e jashtëzakonshëm, atë të aplikimit të dy standardeve, ku kemi parë hatanë për disa qindra mijëra lekë të vjetër për një gjyqtar dhe asgjë për një që ka qindra milionë lekë. Në mënyrë selektive,

të fshehtë për disa, rezultatet botoheshin, për disa të tjerë nuk bëheshin publike kurrë, pati edhe raste skandaloze, siç është rasti i Dvoranit, që drejtonte KED-në e të tjera. Çfarë tregojnë të vërtetat e mëdha? Ato tregojnë se sistemi i drejtësisë ka shtuar në mënyrë ekstreme kohën e gjykimit dhe janë me mijëra çështje të bllokuara për vite me radhë. Pra, shpresa për t'u përmirësuar është zero. Asnjë nuk mund të duartrokasë dot sot për një reformë në drejtësi, e cila i ka bërë qytetarët shqiptarë të largohen nga kjo jetë pa pasur asnjë shans të marrin drejtësi. Faktet tregojnë se Gjykata e Lartë sot që flasim ka 36 mijë çështje dhe mijëra e mijëra të tjera të shpërndara në të gjitha gjykatat përkatëse, gjykatat e apelit punojnë më 30% të personelit dhe mesatarja është me 2 mijë dosje për një gjykatës. Këto janë fakte skandaloze. Këto fakte gjenden edhe në progress-raportin e BE-së, që evidentojnë se ky realitet është i hidhur. Edhe drejtuesit e institucioneve më të larta të ngritura, si: KLGJ, KLP, Gjykatë Kushtetuese, prokurori e të tjera, kanë pohuar mungesa të jashtëzakonshme në sistem. Pra, në vend që të kishim një sistem që duhej të shkëlqente, kemi një sistem në krizë të thellë. Tani do të them dy fjalë për shpërdorimin e jashtëzakonshëm që i është bërë dhe i bëhet mbështetjes dhe advokimit të ndërkombëtarëve, kudo që ata ndodhen, lidhur me procesin. Këta të dashuruarit mbas ndërkombëtarëve, që u dolën rrylat duke folur në emër të tyre, kishin më së miri mundësinë ta tregonin sa i dëgjojnë këta ndërkombëtarë, nëse nuk ka ndonjë pazar mes tyre, kur vjen puna tek Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit. ONM-ja shprehu rezerva shumë të mëdha për rreth 60% të kandidatëve të KLP-së dhe KLGJ-së që sapo u ngrit. Maxhoranca rri e pashqetësuar, megjithëse rekordet e atyre që zgjodhën lëviznin nga harku i ish-spiunëve të Sigurimit deri në evazion dhe fshehje të pasurisë.

Pra, të tërë u zgjodhën rregullisht dhe janë pjesë e këtyre institucioneve. Pra, meqenëse flisni në emër të tyre, ONM-ja ishte BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara, kjo ONM nuk u dëgjua, u përbuz. Kemi parë gjëra të shëmtuara se si është shantazhuar. Pra, këta ndërkombëtarë nuk ekzistuan, por kur vijnë këtu për të justifikuar pazarin e radhës flitet vetëm në emër të tyre, ky është fakti. Atje janë personazhet, të cilët janë denoncuar me emër e mbiemër nga ONM-ja. Për të ecur më tutje, një nga treguesit kryesorë të drejtësisë janë çështjet me të cilat ajo përballet. Për fat të keq, një nga çështjet më sensitive, që u kurorëzua me dënimin e një ishministrit të Brendshëm, ka qenë ajo e filluar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Përballë organeve të reja të drejtësisë janë çështje jashtëzakonisht mëdha, si: çështja e inceneratorëve, një nga skandalet më të mëdha korruptive të gjithë pluralizmit shqiptar; çështja "Beketi" me miliona euro; problemi i madh dhe shumë delikat e kritik i portit të Durrësit, ku lëvizin 2 miliardë euro dhe kompanitë offshore kanë marrë në dorë pasuritë e mëdha kombëtare të vendit; paditë për veprimin e komisionuar të parlamentit, sipas porosive të grupeve oligarkike të interesit të lidhura me qeverinë dhe me plot elemente të tjera që kishin të bënin me botën e krimit. Ndërkohë që priteshin përgjigjeve shumë të forta, organet e reja të drejtësisë bubullonin me arka cironkash në njërin anë apo me hetimin e ndeshjeve të kategorisë së dytë të futbollit në Përmet e gjetkë. Kjo është një situatë që nuk mund të fshihet.

Sabotimi që iu bë reformës dhe skandali i jashtëzakonshëm, ku më i fundit kulmoi në Gjykatën Kushtetuese, ku vetë institucioni i Kuvendit të Shqipërisë u përfshi në një falsifikim e manipulim, saktësisht të karakterit mafioz, dhe ku nuk ka lëvizur asnjë centimetër asnjë nga institucionet e drejtësisë, megjithëse në lojë ishin organi më i madh ligjvënës, kreu i shtetit dhe niveli më i lartë i gjykatave të vendit, Gjykata Kushtetuese, nuk ka ndodhur asgjë. Të gjithë prisnin që kjo drejtësi të ishte në këmbë, por kjo nuk ndodhi. Edhe ajo e vjetra më përpara sekuestronte dhe i ndalonte gazetarët për një deklaratë në studio televizive, ndërsa sot që ndodh një manipulim dhe një falsifikim i përmasave kaq të mëdha, nuk lëviz asnjë. Kjo është drejtësia e re?! Pas parullave do të fshihemi?! Do ta zgjidhim problemin duke bërë sikur shtyjme ca ditë vetingun?! Jo. Por ky është riciklimi i një drejtësie pa kthim, të kapur, që vepron me regji dhe është pikërisht e kundërta e asaj që bëjnë qytetarët. Qytetarët presin rezultatet, rezultatet e tashme janë të zeza, por në të ardhmen do të jenë

edhe më të errëta, nëse vazhdohet të mbahet ky qëndrim ndaj kësaj reforme kaq delikate dhe kaq jetike për vendin, që, për fatin e keq, ka degraduar në kapjen dhe shpërdorimin mafioz të saj.